

**STATUTI I SHOQERISE TREGTARE  
"SHAHINI NDERTIM" SHPK**

**Neni 1**

**Emri**

Emri i shoqerise eshte "SHAHINI NDERTIM" SHPK.

**Neni 2**

**Forma**

Forma e shoqerise eshte ajo e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ("SHPK"), sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Shoqeria "SHAHINI NDERTIM" sh.p.k. zoterohet nga ortaku Devi Shahini, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

**Neni 3**

**Data e themelimit**

Shoqeria eshte themeluar me date 12.10.2020.

**Neni 4**

**Ortaket**

Ortak i vetem i shoqerise eshte DEVI SHAHINI, i cili zoteron 100 % te kuotave te shoqerise.

Ortaku i vetem DEVI SHAHINI, ka lindur me date 19.11.1992 ne Shijak, me shtetesi Shqiptare, me nr.personal J21119007G.

**Neni 5**

**Selia**

Selia e shoqerise eshte ne pasurine nr.5/65-II Zona Kadastrale nr.3369 e llojit Ndertese, nga Kati Perdhe i se ciles ne nje pjese, zyre, me siperfaqe 5 m2, ushtrohet aktiviteti.

Adresa e sakte e selise eshte: Shijak, zona kadastrale 33969, pasuria nr.5/65-II, Ndertese, kati perdhe, me siperfaqe 5 m2.

**Neni 5/1**

**Zyra Qendrore**

Zyra qendrore e shoqerise tregtare eshte ne rruga "Partizani", Bashkia Shijak, ne shtetin Shqiptar.

Ne zbatim te nenit 8 pika 2 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

**Neni 6**

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Punime duroalumini dhe druri, dyer me pakice dhe shumice. Hoteleri, bar restorant. Ndertim, rikonstrukcion banesash etj te ngjashme.

**Neni 7**

**Kohezgjatja e shoqerise**

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.

**Neni 8**

**Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre**

Personi përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë është Z.DEVI SHAHINI, i biri i Mehdi dhe i Shpresa me keto të dhëna identifikimi: lindur më datë 19.11.1992 në Durrës, te rrethit Durrës, me shtetësi Shqiptare dhe me numer personal J21119007G.

Kompetencat e përfaqësimit janë të plota duke i dhënë tanger përfaqësuesit të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe për të gjitha veprimet juridike ku një nga palet e këtyre marrëdhënieve juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqëria "SHAHINI NDERTIM" sh.p.k.

Z.DEVI SHAHINI emërohet si administrator dhe përfaqësues i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, për një afat prej 5 vitesh kalendarike, me të drejtë ripërteritje.

**Neni 9**

**Specimenti i nënshkrimit (firmes) së personit që përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve**

**DEVI SHAHINI**

*Devu Shahini*

**Neni 10**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 leke (njqind) leke.  
Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij te meposhtem:

-Ortaku themelues DEVI SHAHINI, : Zoterues i 1 (nje) kuoteme vlere te pergjithshme 100 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Neni 11**

**Percaktim ligjor i Kapitalit themeltar te shoqerise**

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

Ortaku i vetem z.Devi Shahini zoteron kuoten e tij e cila perben kontributin e tij qe mbulon te gjithe vleren e kapitalit te shoqerise.

**Neni 12**

**Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar**

Vlera nominale e kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 100 (njqind) leke.

**Neni 13**

**Pjesemarrja e kuotes se ortakeve ne kapitalin themeltar te nenshkruar**

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar te kuotes se ortakut te vetem DEVI SHAHINI eshte 100 Leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar.

**Neni 14**

**Vlera dhe lloji i kontributit te ortakut te vetem**

Vlera e kuotes se ortakut te vetem themelues Devi Shahini, eshte 100 leke (njqind) leke.

Lloji i kontributit te ortakut te vetem eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 15**

Kapitali fillestar i nenshkuar do te paguhet ne llogarine e shoqerise nga ana e ortakut te vetem.

**Neni 16**

**Ndalimi i konkurrences**

Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga ortaku i vetem sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 16/1**

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare",

mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

**Neni 17**

**Kalimi i kuotave**

- 1- Kushtezohet kalimi i kuotave te ortakeve te shoqerise "SHAHINI NDERTIM" sh.p.k. me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise, nese ka.
- 2- Ne rast se e drejta e parablerjes nuk eshte shfrytezuar nga asnje prej ortakeve te tjere te shoqerise, atehere per kalimin e kuotave sipas nenit 73 pika 1 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", duhet marre miratimi i shoqerise, me  $\frac{3}{4}$  e votave, i cili autorizon keto kalime.
- 3- Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate, duhet te realizohet ne menyre te detyrueshme me akt noterial.
- 4- Permbajtja e ketij neni mund te ndryshohet vetem me miratimin e me shume ortakeve qe perfaqesojne me shume se  $\frac{4}{5}$  e pjeseve te kapitalit themeltar.

**Neni 18**

**Shperndarja e fitimeve**

Ortaku i vetem ka te drejte te terheqe pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

**Neni 18/1**

Fitimi i shperndahet ortakut ne raport me kuotat e zoteruara.

**Neni 19**

**Te drejtat dhe detyrimet e ortakut te vetem**

Ortaku i vetem i shoqerise "SHAHINI NDERTIM" sh.p.k., ne baze te pikes 3 te nenit 81 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", eshte pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhte:

- 1- Percaktimin e politikave,tregtare te shoqerise;
- 2- Ndryshimet e statutit;
- 3- Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 4- Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- 5- Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likujduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- 6- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- 7- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 8- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- 9- Pjestimin e kuotave dhe anulimi i tyre;
- 10- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- 11- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- 12- Nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsitate pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;
- 13- Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.

## STATUTI I SHOQERISE "SHAHINI NDERTIM" SHPK

- 14- Vendos per nisjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe te ketij statuti.
- 15- Vendos per likujdimin me nje procedure te pershpjktuar sipas nenit 24 te ketij statuti.

### **Neni 19/1**

#### **Regjistri i vendimeve te ortakut te vetem**

- 1- Te gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetem sipas nenit 19 te ketij statuti, regjistrohen ne Regjistrin e vendimeve te ortakut te vetem.
- 2- Te dhenat e regjistrit te vendimeve te ortakut te vetem nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.
- 3- Regjistrohen ne vecanti vendimet per:
  - a- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - b- Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c- Investime;
  - ç- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- 4- Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

### **Neni 20**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e administratorit**

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- 1- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga ortakut i vetem;



## STATUTI I SHOQERISE "SHAHINI NDERTIM" SHPK

---

- 2- Te perfaqesojë shoqerine tregtare;
- 3- Te kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqerise;
- 4- Te përgatise dhe të nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise së veprimtarise dhe propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- 5- Te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencën e shoqerise;
- 6- Te kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqerise, sipas ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
- 7- Te raportojë përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqerise tregtare;
- 8- Nëse janë emëruar dy ose më shumë administratorë, këta e administrojnë bashkërisht shoqerinë. Ortaku i vetëm me vendim të vecante, mund të përcaktojë që të ketë rradhë hierarkike në administrim, nga administratorë të caktuar duke specifikuar rrethanat e kësaj përpalesie ndërmjet administratorëve.
- 9- Në rast likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese, i njofton për regjistrim QKB-së të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre.

### Neni 21

#### Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimi i administratorëve përcaktohet me vendim të zakonshëm të ortakut të vetëm.

## STATUTI I SHOQERISE "SHAHINI NDERTIM" SHPK

Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, ortaku i vetem mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **Neni 22**

#### **Emerimi i likujduesit**

Ne rast se ortaku i vetem vendos per likujdimin e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese, eshte i detyruar te caktojte likujduesin, brenda 30 diteve pas prishjes.

Ne caktimin e likujduesit duhet patur parasysh se ky caktim nuk duhet te paraqese arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likujdimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likujduesi i caktuar.

### **Neni 22/1**

#### **Te drejtat dhe detyrat e likujduesit**

Likujduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Kufizime te caktuara per veprimtarine e likujduesit, mund te vendosen nga ortaku i vetem ne aktin e emerimit te likujduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe kane efekt edhe

## STATUTI I SHOQERISE "SHAHINI NDERTIM" SHPK

ndaj te treteve duke u quajtur te njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr.9901.

Likujduesi ka detyre te ftoje kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

- 1- Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2- Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.
- 3- Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4- Shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5- Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylles se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likujduesit vene re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likujduesi pezullon proceduren e likujdimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.

### **Neni 23**

#### **Shperndarja e aktiveve**

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likujduesi i shperndan ortakut aktivet e mbetura, me radhe preference ne favor te z.DEVI SHAHINI.

### **Neni 24**

#### **Likujdimi i thjeshtezuar**

Me vendim te tij, ortaku i vetem mund te vendose per likujdimin e pershpejtuar.

## STATUTI I SHOQERISE "SHAHINI NDERTIM" SHPK

Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kriterëve te ketij statuti, ortaku i vetem eshte i detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratori i shoqerise njofton per regjitrin prane QKR-se vendimin e mesiperm.

Administratori dhe ortaku i vetem jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

### **Neni 25**

#### **Dispozita te fundit**

Ky statut hyn ne fuqi me regjistrimin e tij prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Miratuar me vendim te ortakut te vetem **DEVI SHAHINI**.  
me numer 01 date 12/10/2020

*Dev Shahini* 